

AKTI I THEMELIMIT DHE

STATUTI

I SHOQERISE "HEALTH PLUS IMPORTS" SHPK

THEMELIMI

NENI 1 - ORTAKET THEMELUES

Shoqeria "HEALTH PLUS IMPORTS" SHPK themelohet nga Ortaket:

Z. Jameson Stephen Simpson , atesia Stephen Frederick Simpson amesia Claire Simpson Jones me dy shtetesi amerikano-kanadez lindur ne Kanada, me 25-06-1976, me nr personal pasaporte 513107451 , madhor dhe me zotesi te plote per te vepruar;

Zj.Alejandra Lagunes Garay, atesia Vincente Mario Lagunes Garza amesia Patricia de la Luz Garay Maldonado shtetase meksikane, lindur ne Meksike, datelindja 18.05.1992 madhore me zotesi te plote juridike per te vepruar identifikuar me pasaporte nr G40220940

EMERTIMI, SELIA, FORMA LIGJORE

NENI 2 — EMERTIMI

Emertimi i shoqerise eshte "HEALTH PLUS IMPORTS " SHPK (me poshte e quajtur "Shoqeria")

NENI 3 - FORMA LIGJORE

3.1 Shoqeria eshte e formes me pergjegjesi te kufizuar dhe eshte themeluar ne perputhje me legjislacionin tregtar ne Shqiperi.

3.2 Shoqeria mund te shnderrohet ne nje forme tjeter ne perputhje me legjislacionin shqiptar.

NENI 4 - BAZA LIGJORE

4.1 Shoqeria do te zhvilloje veprimtarine e saj ne perputhje me kete Akt Themelimi dhe Statut, legjislacionin tregtar dhe dispozita te tjera ligjore ne fuqi.

4.2 Per sa nuk eshte parashikuar ne kete Statut, do te aplikohen dispozitat e ligjit nr. 9901, date 14.04.2008. "Per tregtaret dhe shogerite tregtare", i ndryshuar.

NENI 5 - PERSONALITETI JURIDIK . KOHEZGJATJA

5.1 Shoqeria fiton personalitet juridik me regjistrimin e saj ne Regjistrin Tregtar prane Qendres Kombetare te Regjistrimit ne Tirane, Shqiperi.

5.2 Afati i veprimtarise se shoqerise eshte per nje periudhe te papercaktuar.

NENI 6 - SELIA

6.1 Selia e shoqerise eshte ne adresen: Rr."Haxhi Hysen Dalliu", P.200 Sh.2, kati 4, Ap.11, Tirane

6.2 Shoqeria mund te hapé dege, filiale apo zyra perfaqesie si brenda territorit te Shqiperise ashtu dhe jashte saj.

6.3 Shoqeria mund te marre pjese ne shoqeri te tjera shqiptare ose te huaja qe ekzistojne ose do te krijohen ne te ardhmen.

NENI 7

EMBLEMA. VULA

7.1 Shoqeria do te kete emblemen dhe vulen e saj. Vula do te perdoret nga administratoret e shoqerise.

7.2 Forma dhe permasat e vules do te percaktohen ne perputhje me rregullat e legjislacionit shqiptar.

7.3 Te gjitha dokumentet e shoqerise duhet te permbajne emblemen dhe vulen e saj.

NENI 8

OBJEKTI

8.1 Objekti i veprimtarise se Shoqerise do te jete: import, eksport, tregtim dhe shperndarje suplementesh dhe vitaminash, produkte ushqimore organike, pajisjesh mjekesore etj. Sherbime te arteve sheruese "healing arts"-shiatsu therapy

8.2 Shoqeria mund te kryeje cdo aktivitet tjeter te nevojshem e te dobishem per permbushjen e objektit dhe objektive te shoqerise i cili eshte ne perputhje me Ligjet e Republikes se Shqiperise.

NENI 9

KAPITALI THEMELTAR

9.1 Kapitali themeltar fillestar i shoqerise eshte 100.000 Leke (leke).

9.2 Kapitali themeltar perbehet nga 2 (dy) kuota.

Z. Jameson Stephen Simpson. zoteron 1 (nje) kuote me vlere norninale 50,000 (pesedhete mije) Leke qe perben 50% te kapitalit themeltar te shoqerise.

Zj.Alejandra Lagunes Garay 1 (nje) kuote me vlere nominale 50,000 (dyzete e nentemije) Leke qe perben 50% te kapitalit themeltar te shoqerise.

9.4 Kapitali eshte shlyer teresisht.

NENI 10

TRANSFERIMI I KUOTAVE. KUFIZIMET

10.1 Kuota e kapitalit eshte e transferueshme dhe mund te transferohet ne cdo moment sipas kushteve dhe afateve te parashikuara nga ligji shqiptar.

10.2 Vendosja e cfaredolloj barre mbi pjeset e kapitalit ne favor te paleve te treta do te lejohet vetem me pelqimin e Asamblese se Ortakeve.

NENI 11

Rritja e Kapitalit

11.1 Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet ose zvogelohet me vendim te Asamblese se Ortakeve

11.2 Zmadhimi i kapitalit mund te behet gjithashtu edhe nepermjet nenskrimit dhe shlyerjes se pjeseve te tjera te kapitalit te ortakeve te rinj. Ortaket e rinj pranohen dhe miratohen si te tille me vendim te Asamblese se Ortakeve.

Neni 12



Zvogelimi i kapitalit

12.1 Zvogelimi i kapitalit behet sipas procedurave te parashikuara nga legjislacioni tregtar

12/2 Propozimi I zvogelimit do t'i paraqitet ekspertit kontabel te autorizuar dhe administratorit te pakten 30 dite para marrjes e vendimit nga Asambleja e Ortakeve te Shoqerise. Eksperti kontabel dhe administrator do te shqyrtojne propozimin dhe do t'i paraqesin Asamblese raportin ne lidhje me arsyet dhe kushtet e zvogelimit te kapitalit

12.3 Raporti I zvogelimit te kapitalit do miratohet me vendim te Asamblese se Ortakeve.

ORGANET E SHOQERISE

NENI 13

VENDIMET E ASAMBLESE SE ORTAKEVE

Asambleja e Ortakeve ne perputhje me legjislacionin shqiptar, mund te marre, por pa u kufizuar ne to, vendimet me poshte:

- percaktimin e politikave tregtare te shoqerise dhe mbikeqyrjen e zbatimit te tyre nga administratori ose administratorete, perfshire raportet financiare;
- zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit; miratimin e shkrirjes/bashkimit me shoqeri te tjera;
- ndryshimin e statutit te shoqerise;
- ndryshimin e selise dhe te emertimit te shoqerise;
- emerimin e eksperteve kontabel te autorizuar, ne qofte se eshte e nevojshme;
- rritjen ose zvogelimin e kapitalit themeltar te shoqerise;
- Shitjen ose transferimin e pjeseve te kapitalit themeltar paleve te treta;
- Ristrukturimin dhe prishjen e shoqerise;
- Emerimin ose shkarkimin e administratorit ose administratoreve te shoqerise;
- Miratimin e pasqyrave financiare te shoqerise dhe raportit te administratorit(eve);
- Vendimin per shperndarjen e fitimit dhe mbulimin e humbjeve transformimin e shoqerise ne forma te tjera; dhe cdo lende tjeter te parashikuar nga statuti ose nga ligji.

NENI 14

ADMINISTRIMI



14.1 Asambleja e Përgjithshme emerion një ose me shumë persona fizike si administrator të shoqërisë. Afati i emerimit është 5 vjet, me të drejtë riperteritjeje. Emerimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në QKB

Administratorët e një shoqërie tregtare mëmë, nuk mund të emerohen si administrator të një shoqërie të kontrolluar dhe e anasjelltas. Çdo emerim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm

14.2 Administratorë të shoqërisë janë:

Z. Jameson Stephen Simpson, atesia Stephen Frederick Simpson atesia Claire Simpson Jones me detyruesi amerikan-kanadez lindur në Kanada, më 25-06-1976, me nr pasaportë personale 513107451, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar;

Zj. Alejandra Lagunes Garay, atesia Vincente Mario Lagunes Garza atesia Patricia de la Luz Garza Maldonado shtetase meksikane, lindur në Meksikë, datelindja 18.05.1992 madhore me zotësi të plotë juridike për të vepruar identifikuar me pasaportë nr G40220940

NENI 15

Kompetencat e Administratorëve

15.1 Administratorët kanë të drejtë dhe detyrohen të veprojnë si më poshtë:

a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;

b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare;

c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
ç) përgatit dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;

d) krijon një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;

dh) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;

e) raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

ë) kryen detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

15.2 Administratorët janë të detyruar të therrasin Asambleenë e Përgjithëshme, në rastet kur:

- sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.

15.3 Asambleja e përgjithëshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme.

NENI 16

Përgjegjësia e Administratoreve

16.1 Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

16.2 Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorëve dhe ortakeve /ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

16.3 Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithëshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqërite Tregtare", administratori detyrohet:

a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;

b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;

c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;

ç) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;

d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

16.4 Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjet ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

16.5 Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë

realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare. 16.6 Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit „ Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare , kryen veprimet e mëposhtme:

a) u kthen ortakëve kontributet;

b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;

c) u shpërndan aktivet shoqërisë;

ç) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;

d) jep kredi.

NENI 17

VITI FINANCIAR

17.1 Viti financiar i shoqërisë perputhet me vitin kalendarik, duke filluar nga 1 Janari dhe perfundon me 31 Dhjetor te cdo viti.

17.2 Perjashtimisht, viti i pare financiar i shoqërisë do to filloje nga dita e regjistrimit te shoqërisë ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe perfundon me 31 Dhjetor te po atij viti

NENI 18

BILANCI. KONTABILITETI.

18.1 Bilancl vietor i shoqërisë shqyrtohet nga Asambleja e Ortakëve dhe duhet te pergatitet per t'u paraqitur para organeve tatimore dhe Qendres Kombetare te Regjistrimit deri ne fund te muajit Mars te cdo viti pasardhes.

18.2 Kontabiliteti mbahet ne gjuhen dhe monedhen shqiptare si dhe sipas kerkesave te legjislacionit perkates. Per operacione te vecanta, shoqëria mund te beje veprime edhe me llogari te vecanta ne monedhe te huaj, duke bere konvertimin brenda vitit.

18.3 Shoqëria mund te pranoje fonde nga institucionet financiare qe operojne ne Shqiperi ose jashte. Per kete qellim shoqëria mund te lere peng pjese te kapitalit si garanci ose mund te hipotekojë pasurite e saj te paluajtshme, vetem me vendim te Asamblese se Ortakëve.

NENI 19



TE ARDHURAT, DIVIDENDI

19.1 Shoqeria mund te krijojë fonde rezerve per realizimin e qellimeve te aktivitetit te saj ne perputhje me kerkesat e ligjit Nr. 9901. date 14.4.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare"

19.2 Fitimet qe do te rezultojne ne fund te mbylljes se cdo viti ushtrimor, pas pagimit te tatimeve, mund te ndahen nga Asambleja e Ortakeve.

19.3 Humbjet e shoqerise do te mbulohen den i ne kufirin e kapitalit themeltar dhe cdo ortak do te pergjigjet deri ne kufirin e kontributit te tij ne kapitalin themeltar te shoqerise

PRISHJA-RIORGANIZIMI I SHOQERISE

NENI 20

PRISHJA DHE LIKUJDIMI

- 20.1 Shperndarja ose prishja e shoqerise mund të behet ne cdo kohe :
- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
 - b) me vendim të Asamblese se Ortakeve;
 - c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
 - ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";
 - d) me vendim të gjykatës;
- 20.2 Ne kete rast Ortaket merrin vendim me shkrim ne të cilin parashikojne menyren e likuidimit të shoqerise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesën shtese " Shoqeri ne likuidim e siper "
- 20.3 Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.
- 20.4 Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaket me vendim asambleje
- 20.5 Nëse Ortaket nuk merrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

NENI 21

RIORGANIZIMI I SHOQERISE –BASHKIMI , NDARJA

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare."

NENI 22

Mosmarrëveshjet

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare.

ORTAKËT

E SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

“HEALTH PLUS IMPORTS” SHPK

JAMESON STEPHEN SIMPSON

ALEJANDRA LAGUNES GARAY

JAMESON STEPHEN SIMPSON

Alejandra Lagunes Garay



Date 26.08.2021